

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6532
E enjte, 10 shkurt 2022
çmimi 0.40 €

Kosova sanksionon individë dhe entitete bjellbruse



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KUVENDI I KOSOVËS KA MBAJTUR SEANCË TË JASHTËZAKONSHME PËR VENDIMIN E ZYRËS SË RREGULLATORIT PËR ENERGJI (ZRRE) PËR TARIFAT E REJA TË ENERGJISË ELEKTRIKE

OPOZITA: ZRRE-ja VULOSI PROPOZIMIN E VETËVENDOSJES PËR SHTRENJTIM TË RRYMËS



Në ditën që ka hyrë në fuqi vendimi i Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) për shtrenjtimit e energjisë elektrike, opozita ka vlerësuar se vendosja e tarifave të reja të energjisë elektrike është politike dhe e kundërligjshme. Në seancën e jashtëzakonshme parlamentare që kishin thirrur deputetët e PDK-së, të LDK-së dhe të AAK-së, ata kanë thënë se ZRRE-ja ka vulosur propozimin e Lëvizjes Vetëvendosje për shtrenjtimit e energjisë elektrike. Sipas tyre, tarifat e reja janë haraç për qytetarët e Kosovës. Opozita në këtë seancë ka propozuar rezolutë kundër shtrenjtimit të energjisë elektrike që të ndalohet vendimi i ZRRE-së, por kjo rezolutë mori vetëm 30 vota, jo të mjaftueshme për të kaluar

AKTUALE



SLLOVAKIA MIRATON TRAKTATIN PËR DHËNIEN E DY BAZAVE AJRORE SHBA-së

OSMANI BËN THIRRJE PËR UNIFIKIM TË FAKTORIT POLITIK SHQIPTAR NË LUGINË

ÇEKU THOTË SE PRESIN TA VAZHDOJNË PROJEKTIN PËR RESTAURIMIN E SHËNËSË SË XHAFER DEVËS

EKONOMI



KESCO THOTË SE ËSHTË E GATSHME T'I ZBATOJË TARIFAT E REJA TË RRYMËS

ULET TARIFA PËR DEPOZITIM TË MONEDHAVE NË BOK

SPORT



ADEMI TAKOHET ME DREJTUESIT E LARTË TË FIFA-s

Formohet këshilli organizativ për manifestimin e Epopesë së UÇK-së



AGK-ja dhe shoqëria civile dënojnë sulmet e bashkëshortit të Presidentes Osmani ndaj gazetarëve

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Slovakia miraton traktatin për dhënien e dy bazave ajrore ShBA-së

BRATISLAVË, 9 SHKURT - Parlamenti i Sllovakisë të mërkurën ka miratuar një traktat për mbrojtje ushtarake me Shtetet e Bashkuara.

Marrëveshja për Bashkëpunim të Mbrojtjes kaloi me 79 vota për dhe 60 kundër.

Ky traktat do t'i lejojë ushtrisë amerikane që të përdorë dy baza ajrore, bazën Malacky-Kuchyna dhe Sliac - për dhjetë vjet në Sllovakë, shtet anëtar të NATO-s. Si shpërblim Sllovakia do të marrë 100 milionë dollarë nga ShBA-ja me qëllim të modernizimit të bazave.

Marrëveshja u nënshkrua nga sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, dhe ministri i Mbrojtjes i Sllovakisë, Jaroslav Nad, më 3 shkurt në Uashington. Kjo marrëveshje duhet të ratifikohet edhe nga presidentja Zuzana Caputova, e cila e mbështet traktatin.

Votimi për këtë traktat ndodh në kohën e rritjes së frikës se Rusia po planifikon ta pushtojë Ukrainën. Moskë ka vendosur

mbi 100 000 trupa përgjatë kufijve të Ukrainës, por insiston se nuk po planifikon ndonjë sulm. Sllovakia gjendet në kufi me Ukrainën. Traktati është mbështetur nga Qeveria e kryeministrit Eduard Heger, i cili ka thënë se do ta "rrisë sigurinë tonë në mënyrë të konsiderueshme".

Por, marrëveshja është kundërshtuar fuqishëm nga opozita, që ka argumentuar se ajo komprometon sovranitetin e shtetit, duke bërë që prania e trupave ushtarake në territorin sllovak të jetë e përhershme. Po ashtu, opozita ka thënë se traktati mund të mundësojë edhe dislokimin e armëve bërthamore në Sllovakë.

Qeveritë në Sllovakë dhe ShBA kanë hedhur poshtë këto akuza. "Asgjë në marrëveshjen e sotme nuk krijon bazë të përhershme për ShBA-në apo për prani të përhershme të trupave amerikane në Sllovakë dhe marrëveshja respekton plotësisht sovranitetin dhe ligjet sllovake",



ka deklaruar sekretari Blinken gjatë ceremonisë së nënshkrimit të traktatit.

Mijëra qytetarë protestuan të martën para Parlamentit kur deputetët sllovakë nisën diskutimet për këtë temë.

Protesta bashkoi opozitën

sllovake, përfshirë partinë e ekstremit të djathtë, Partia Popullore për Sllovakinë Tonë dhe partinë e majtë, Partinë Socialdemokrate të ish-kryeministrit, Robert Fico.

ShBA-ja ka arritur marrëveshje të ngjashme me 23 shtete të tjera të

NATO-s, përfshirë Poloninë dhe Hungarinë, që janë dy shtete fqinje të Ukrainës në krahun lindor të aleancës ushtarake. Sipas marrëveshjes, çdo dislokim i trupave amerikane duhet të miratohet nga Qeveria dhe Parlamenti i Sllovakisë.

Edhe 16 miliardë dollarë të nevojshme për ta luftuar pandeminë



GENEVË, 9 SHKURT - Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh) ka thënë se edhe 16 miliardë dollarë duhen për t'i mbështetur shtetet me të ardhura të ulëta për të luftuar pandeminë e koronavirusit. Sipas saj, ky buxhet është i nevojshëm për t'i furnizuar shtetet me vaksina, teste dhe ilaçe, përmes një programi të lansuar nga Kombet e Bashkuara. "Shkenca na ka dhënë mjetet për të luftuar Covid-19; nëse ato ndahen në botë në shenjë solidariteti, ne mund t'i japim fund koronavirusit si emergjencë globale këtë vit", ka thënë shefi i OBSh-së, Tedros Adhanom Ghebreyesus.

Sipas kalkulimeve të OKB-së, 92 për qind e kontributeve të kërkuara duhet të sigurohen nga Bashkimi Evropian dhe 20 shtetet më të industrializuara në botë (G20).

Gordon Brown, ambasador i OBSh-së për financim në shëndetin publik, ka kritikuar pabarazinë e madhe për shpërndarjen e vaksinave dhe qasjen në teste dhe ilaçe. Ai ka theksuar se në vendet e varfra ka shkallë të ulët të vaksinimit, ndërkohë që në shtetet e pasura ka vaksina që priret t'u dalë afati. OBSh ka vënë synim që 70 për qind e popullsisë botërore të vaksinohet kundër koronavirusit në mesin e këtij viti.

EMA shqyrton dozën përforcuese të "Pfizer"-it për fëmijët

AMSTERDAM, 9 SHKURT - Rregullatori i Bashkimit Evropian për barna ka njoftuar se po shqyrton nëse do të autorizojë për përdorim dozën përforcuese të "Pfizer/BioNTech" për fëmijët 12-15 vjeç. Ky njoftim erdhi pasi disa shtete në rajon veçse kanë nisur fushatën e imunizimit kundër koronavirusit me doza përforcuese të kësaj grupmoshe.

Në njoftimin e Agjencisë Evropiane të Barnave (EMA) u tha se shqyrtimi i dozës

përforcuese për tinxherët 16 dhe 17 vjeç është në proces e sipër.

Komiteti për vaksina në Gjermani muajin e kaluar ka rekomanduar që të gjithë fëmijët nga mosha 12 deri në 17 vjeç mund ta marrin dozën përforcuese, teksa infektimet me koronavirus në mesin e të rinjve janë rritur.

Edhe shtete të tjera kanë vepruar njësojë.

EMA tha se "këshilla se si vaksinat duhet të jepen mbetet"



në dorën e grupeve këshilluese të shteteve anëtare të BE-së.

Qendra Evropiane për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve (ECDC) tha se gjetjet e një studimi kanë sugjeruar rritje të efektivitetit të vaksinave ndaj infeksionit tek adoleshentët që kanë marrë dozën përforcuese në krahasim me ata që kanë marrë vetëm dy doza të vaksinës. ECDC tha se dhjetë shtete të BE-së veçse kanë rekomanduar dhënien e dozave përforcuese për personat nën 18 vjeç.

Kosova sanksionon individë dhe entitete bjelloruse

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 9 SHKURT - Qeveria e Kosovës ka sanksionuar 183 individë dhe 26 entitete të Bjellorusisë që janë të lidhur me regjimin e udhëheqësit autoritar bjellorus,

Alyksandr Lukashenka. Në mbledhjen e ekzekutivit të mbajtur të mërkurën, u tha se Kosova do t'i zbatojë sanksionet e vendosura nga Këshilli i Bashkimit Evropian. Zëvendësministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Liza Gashi, tha se të gjitha masat kufizuese janë ndërmarrë në koordinim me Shtetet e Bashkuara, Bashkimin Evropian dhe Kanadanë. "Duke pasur gjithnjë qëllim promovimin dhe mbrojtjen e paqes, demokracisë dhe të drejtave të njeriut, kemi marrë një vendim që do të kontribuonte në vazhdimësi të bashkëpunimit të ngushtë me ShBA-në, BE-në dhe partnerët ndërkombëtarë", ka thënë gjatë mbledhjes zëvendësministrja për Punë të Jashtme dhe Diasporë, Liza Gashi.

Në sanksione përfshihet ngrirja e aseteve në Republikën e Kosovës, ndalimi i udhëtimit për individët e sanksionuar si dhe ndalimi që individët dhe entitetet në Republikën e Kosovës të vendosin fonde në mënyrë direkte apo indirekte për individët dhe entitetet e sanksionuara.



Nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës nuk kanë konfirmuar për "Radion Evropa e Lirë" nëse individët dhe entitetet e sanksionuara kanë asete në Republikën e Kosovës.

Bashkimi Evropian në dhjetor të vitit të kaluar kishte vendosur pakon e pestë të sanksioneve ndaj individëve dhe entiteteve të lidhura me Lukashenkan.

Lukashenka pretendon se ka fituar zgjedhjet e gushtit të vitit 2020, pretendim që është kundërshtuar nga opozita. Pakënaqësitë rreth manipulimit të rezultatit zgjedhor nxitën protesta masive në Bjellorusi, të cilat u shtypën me forcë nga regjimi i Lukashenkas.

Sanksionet e fundit të BE-së dhe Kosovës, po ashtu, kanë të bëjnë edhe me nxitjen e një krize me migrantë në kufijtë në mes të Bjellorusisë dhe shteteve të BE-së në fundin e vitit të kaluar.

Formohet këshilli organizativ për manifestimin e Epopesë së UÇK-së

Qeveria e Kosovës ka themeluar të mërkurën Këshillin Organizativ për manifestimin gjithëpopullor për shënimin e Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që do të mbahet nën përkujdesjen e kryeministrit të Republikës së Kosovës, Albin Kurti. "Duke vlerësuar se Epopeja e UÇK-së e ndryshoi historinë e Kosovës për mbarë dhe e bashkoi popullin tonë, duhet të kujtojmë ditët 5, 6 dhe 7 mars, sakrificën e familjes Jashari dhe

qëndresën e tyre", ka thënë kryeministri Kurti.

Duke propozuar këtë këshill, kryeministri ka thënë se gjithçka që "bëjmë e veprimë, çdo progres i yni duket pak, krahas gjithçkaje që ata dhanë". "Duke iu falënderuar atyre, dëshmorëve e martirëve, jemi edhe ne sot këtu. Kujtimi për ta na bën të vetëdijshëm, që ata nuk harrohen, që ne duhet të qëndrojmë, të mos dorëzohemi e ta ndërtojmë republikën që ua

kemi borxh", ka thënë Kurti.

Këshilli Organizativ ka këtë përbërje: Armend Mehaj, ministër i Mbrojtjes - kryesues; Donika Gërvalla, zëvendëskryeministre e dytë dhe ministre e Punëve të Jashtme dhe Diasporës - anëtare; Fadil Nura, kryetar i komunës së Skenderajt - anëtar; Albulena Haxhiu, ministre e Drejtësisë - anëtare; Hajrulla Çeku, ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit - anëtar; Xhelal Sfeçla, ministër i

Punëve të Brendshme - anëtar; Bashkim Jashari, komandant i Forcës së Sigurisë së Kosovës - anëtar; Bislim Zogaj, drejtor i Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës - anëtar.

Nga një anëtar në këtë këshill do ta kenë: Zyra e Presidentes, Kuvendi i Kosovës, Komuna e Prishtinës, Organizatat e Dala nga Lufta e UÇK-së, Asociacioni i Komunave të Kosovës dhe organizatat e shoqërisë civile.

Pesë viktima dhe mbi 100 raste të reja me Covid në Kosovë

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 9 SHKURT - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në Kosovë janë regjistruar pesë viktima dhe 1140 raste të reja me Covid-19. Sipas njoftimit, rastet dolën pas testimit të 6767 mostrave, që i bie se 16.84 për qind e të testuarve kanë rezultuar pozitivë me sëmundjen Covid-19. Në 24 orët paraprake 3624 persona janë shëruar nga koronavirusi. Raste aktive janë 18506.

Ndërkaq, sa i përket vaksinimit, autoritetet shëndetësore kanë

administruar edhe 1312 doza të vaksinës kundër koronavirusit.

Deri më tani në Kosovë me dy doza të vaksinës janë imunizuar 809228 persona.

Në Kosovë të drejtë vaksinimi kanë të gjithë personat nga moshja 12-vjeçare. Ndërkaq, dozën përforcuese dhe atë të tretë mund ta marrin të gjithë personat nga moshja 18-vjeçare, të cilët para tre muajsh janë imunizuar me dy doza të vaksinës.

Një pikë e re e vaksinimit kundër Covid-19 do të aktivizohet nga sot (e enjte) në sheshin "Zahir Pajaziti" të Prishtinës.

Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se kjo po bëhet me qëllim të ofrimit të sa më shumë mundësive për qytetarët për marrjen e vaksinës.

Vaksinimi kundër Covid-19 në Prishtinë, përveç në QMF-7 në lagjen Kalabria (ish-Emshir), në Qendrën Tregtare "Albi Mall" dhe në sheshin "Zahir Pajaziti", së shpejti do të fillojë edhe në një pikë tjetër të re në Kodrën e Trimave në Prishtinë (QMF-2).

Ministria e Shëndetësisë u bënte thirrje qytetarëve që të shfrytëzojnë çdo mundësi dhe të vaksinohen kundër Covid-19.

Në 10 ditët e fundit në Shqipëri kanë humbur jetën në aksidente 10 qytetarë

TIJANË, 9 SHKURT (ER) - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka shprehur shqetësim për rritjen e numrit të aksidenteve dhe humbjen e jetëve të shtetasve shqiptarë në rrugët e Shqipërisë. "Sipas raporteve zyrtare, në 10 ditët e fundit kanë ndërruar jetë 10 qytetarë dhe mbi 25 janë plagosur në aksidente

automobilistike në akse të ndryshme rrugore të vendit, çka përbën një bilanc tragjik të paprecedentë për numrin shumë të lartë të viktimave në këtë periudhë të vitit", ka shkruar Meta në llogarinë e vet në "Facebook". Ai u ka bërë thirrje autoriteteve përgjegjëse të Policisë së Shtetit dhe Ministrisë së

Infrastrukturës dhe Energjetikës të marrin masa të menjëhershme për rritjen e sigurisë rrugore në mbrojtje të jetës së qytetarëve. "U bëj thirrje të gjithë qytetarëve të jenë sa më të kujdesshëm për drejtimin e automjeteve të tyre dhe t'i zbatojnë rregullat e qarkullimit rrugor!", ka shkruar Meta.





KUVENDI I KOSOVËS KA MBAJTUR SEANCË TË JASHTËZAKONSHME PËR VENDIMIN E ZYRËS SË RREGULLATORIT PËR ENERGJI (ZRRE) PËR TARIFAT E REJA TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Opozita: ZRRE-ja vulosi propozimin e Vetëvendosjes për shtrenjtim të rrymës

Në ditën që ka hyrë në fuqi vendimi i Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) për shtrenjtimin e energjisë elektrike, opozita ka vlerësuar se vendosja e tarifave të reja të energjisë elektrike është politike dhe e kundërligjshme. Në seancën e jashtëzakonshme parlamentare që kishin thirrur deputetët e PDK-së, të LDK-së dhe të AAK-së, atëkrah thënë se ZRRE-ja ka vulosur propozimin e Lëvizjes Vetëvendosje për shtrenjtimin e energjisë elektrike. Sipas tyre, tarifave të reja janë haraç për qytetarët e Kosovës. Opozita në këtë seancë ka propozuar rezolutë kundër shtrenjtimit të energjisë elektrike që të ndalohet vendimi i ZRRE-së, por kjo rezolutë mori vetëm 30 vota, jo të mjaftueshme për të kaluar

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

Prishtinë, 9 shkurt - Deputetët e partive opozitare e kanë kundërshtuar vendimin e Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) për tarifave të reja të energjisë elektrike, i cili është marrë një ditë më parë. Në seancën e jashtëzakonshme parlamentare të thirrur nga opozita të mërkurën, në të cilën ka marrë pjesë qeveria, deputetët e PDK-së, të LDK-së dhe të AAK-së kanë thënë se vendimi i ZRRE-së për shtrenjtimin e energjisë

elektrike është politik. Sipas tyre, ai është ndikuar drejtpërdrejt nga propozimi i partisë në pushtet. Opozita në këtë seancë ka propozuar rezolutë kundër shtrenjtimit të energjisë elektrike që të ndalohet vendimi i ZRRE-së, por kjo rezolutë mori vetëm 30 vota, jo të mjaftueshme për të kaluar. Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka thënë se shtrenjtimi i energjisë elektrike është i papërbalueshëm për jetesën e qytetarëve të Kosovës. "Dje kjo zyrë nuk ndërmoi një

vendim të pavarur, por vulosi një vendim politik të propozuar në kurriz të qytetarëve nga mazhoranca e këtij Kuvendi. Nga deputetët e Vetëvendosjes dhe nga ministrat e Vetëvendosjes. Nga shtrati i një partie dhe një kryeministri që erdhi në pushtet duke premtuar pikërisht zbritjen e këtij çmimi. Zyrë, e cila, me vendimin e saj, doli të jetë jo veç mbi Kuvendin, por edhe mbi Kushtetutën dhe mbi sovranitetin, që i ndau qytetarët e Kosovës në subjekte të pabarabarta, duke u qitur haraç disave për ta mbuluar

koston e disa të tjerëve", ka thënë ai.

Lideri i PDK-së ka ritheksuar se, pavarësisht prej paralajmërimeve drejtuar qeverisë për krizën, ajo e ka injoruar komplet atë dhe nuk ndërmoi kurrfarë mase, duke pasuar me reduktime të ashpra dhe me rritjen e çmimit të energjisë elektrike. "Kjo shpikje kaq praktike nuk do të duhej t'i shpëtonte as Komitetit të Nobelit. Por, megjithatë, në komunitetin e shkencëtarëve ekziston një shprehje, se mënyra më e sigurt për të fituar Nobelin është të punosh në laboratorin e dikujt që e ka fituar atë para teje. Fatkeqësisht, Albin Kurti, ndonëse ka pasur mjaft kohë të mësojë, nuk ka marrë mësim se si qeveriset një vend në mënyrë stabile e pa u rënë në qafë qytetarëve. Debatin për atë se çfarë është dashur të ndërmerret me kohë, e kemi shterur më herët dhe s'ka pasur

efekt për qeverinë. Debatin për ta parandaluar këtë vendim që u ndërmoi nga ZRRE-ja, qeveria përmes mazhorancës së vet, dje nuk e la as të shtrohet", është shprehur Krasniqi.

Edhe deputetja e Lidhjes Demokratike të Kosovës, Hykmete Bajrami, e ka fajësuar qeverinë për rritjen e çmimit të energjisë elektrike. Ajo ka thënë se ZRRE-ja ka lajthitur me çmime në dokumentin konsultativ. "Mungesa e qeverisë është evidente kur po diskutojmë çështjen më të rëndësishme për qytetarët tanë. Kam dashur të flas më shumë me ministren e Ekonomisë e kryeministrin sesa me qytetarët, të cilët janë në dijeni për pasojat e këtij vendimi. ZRRE-ja ka bërë shkelje jashtëzakonisht të mëdha. Jo vetëm që ka marrë vendim t'i dyfishojë tarifave, por i ka vënë në lajthitje të gjitha institucionet e Kosovës,

AGK-ja dhe shoqëria civile dënojnë sulmet e bashkëshortit të presidentes Osmani ndaj gazetarëve

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 9 SHKURT - Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) është i alarmuar me gjuhën denigruese që Zotëria i Parë i Kosovës, Prindon Sadriu, ka përdorur ndaj gazetarëve dhe medieve në Kosovë, duke i quajtur ato "ndërmarrje të përbashkëta kriminale". "Kur përfaqësuesit e ndërmarrjeve të përbashkëta kriminale, 'gazetarët' e parapolitikës, e persona të përfshirë në reket e në keqpërdorime milionëshe, moralizojnë. Janë këta moralizues e shpifës të cilët paguanin një natë akomodim me Nju-Jork \$1.200 në Hotel Intercontinental Manhattan, e mëngjesin e paguanin \$50 për person (drekat e darkat iu shkonin deri në mijëra dollarë)", ka shkruar Sadriu të martën në llogarinë e vet në "Facebook", i cili, pas disa orësh, e ka fshirë postimin.

AGK-ja ka theksuar se akuzat dhe sulmet që vijnë nga bashkëshorti i presidentes, që gjithashtu mban post shtetëror në MPJ, shton pasigurinë e gazetarëve në Kosovë. "Po ashtu, në ditët e fundit edhe gjuha e zëdhënësve dhe eksponentëve të tjerë të partisë në pushtet në raport me mediet ka qenë e papranueshme dhe paraqet presion direkt në punën e tyre", thuhet në reagimin e AGK-së.

Kryetari i Këshillit të Medieve të Shkruara të Kosovës, Imer Mushkolaj, ka thënë se duhet të merren masa ndaj bashkëshortit të presidentes Vjosa Osmani, Prindon Sadriu, i cili po përdor gjuhë linçuese kundër gazetarëve dhe medieve.

Mushkolaj ka shkruar në llogarinë e vet në "Facebook" se Prindon Sadriu nuk është vetëm bashkëshorti i presidentes Vjosa Osmani, por është edhe diplomat i rangut të lartë, zyrtar shtetëror. "Është edhe epror rezervë në FSK.



Tash disa ditë ai përdor gjuhë linçuese kundër gazetarëve dhe medieve. Ministria e Jashtme dhe FSK urgjentisht duhet të marrin masa ndaj tij dhe të veprojnë sipas rregullativave ligjore në fuqi. Ai nuk mund që, në përpjekje për t'i mbuluar bëmat e bashkëshortes, të akuzojë gazetarë e media me fjalor të ulët që, mbase, mund ta përdorë ndonjë militant i frustruar, por kursesi një diplomat", ka shkruar Mushkolaj.

Profesori i filozofisë politike, Blerim Latifi, e ka quajtur të rrezikshme gjuhën e përdorur të Zotërisë së Parë, Prindon Sadriu, ndaj medieve. Latifi ka shkruar në "Facebook" se s'është injoruar faktin që autoritarizmi fillon nga gjuha e kriminalizimit të zërave kritikë. "Kur një zyrtar i lartë i shtetit mediet dhe gazetarët i kualifikon si 'ndërmarrje e përbashkëta kriminale' atëherë, logjikisht dhe juridikisht, i bie që

prokuroria dhe policia të shfaqen në ndërtesat e medieve dhe në banesat private të gazetarëve për t'i dërguar të gjithë në burg", ka shkruar Latifi në llogarinë e vet në "Facebook".

Ai ka shkruar se kjo gjuhë e zyrtarëve shtetërorë ndaj gazetarëve dhe mosdurimi i tyre agresiv ndaj kritikës publike janë shumë të rrezikshme. "Sot ne jemi larg situatës me të cilën përballen gazetarët në regjimet e tilla si ai i Putinit e i Erdoganit, por nuk duhet injoruar fakti se autoritarizmi fillon nga gjuha e kriminalizimit të zërave kritikë dhe mbjellja e frikës. Sepse, siç argumenton bindshëm Monteskje, diktaturat lindin dhe ushqehen nga frika. Kosova sot qëndron më mirë se të gjithë të tjerët në rajon në indeksin e lirisë së medieve dhe secili nga ne që beson në demokraci, duhet të angazhohemi për ruajtjen e këtij avantazhi", ka shkruar profesori Latifi.

Osmani bën thirrje për unifikim të faktorit politik shqiptar në Luginë

PRISHTINË, 9 SHKURT (ER) - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani-Sadriu, ka pritur të mërkurën në takim një delegacion nga Kuvendi Komunal i Bujanocit, i përbërë nga Enver Ramadani, kryetar i Kuvendit Komunal, Afërdita Mustafa, këshilltare në Kuvend Komunal, Nerminë Aliji Ademi, sekretare e Kuvendit dhe Fisnik Beluli, shef i kabinetit të kryetarit të Kuvendit. Presidentja Osmani ka bërë me dije angazhimin e vazhdueshëm të Presidentes dhe të gjitha institucioneve të tjera të

Republikës së Kosovës për adresimin e problemeve me të cilat përballen shqiptarët e Luginës së Preshevës. Ajo ka theksuar se në të gjitha takimet me përfaqësues ndërkombëtarë në vazhdimësi ka ngritur këto probleme, duke synuar ndërkombëtarizimin e problemeve të shqiptarëve në Luginë të Preshevës.

Në këtë takim presidentja Osmani ka theksuar rëndësinë e bashkëpunimit mes institucioneve të Republikës së Kosovës dhe përfaqësuesve shqiptarë në Luginë, duke

siguruar trajtim të menjëhershëm të të gjitha shqetësimeve të shqiptarëve në Luginë nga ana e institucioneve të Kosovës.

Presidentja Osmani ka bërë thirrje për bashkëpunim të faktorit politik shqiptar në Luginë, duke e konsideruar si mënyrën e vetme e cila siguron trajtimin e duhur të problemeve të shqiptarëve në Luginë. Ajo, po ashtu, ka rikonfirmuar qëndrimin e saj dhe të të gjitha institucioneve të vendit për përkrahje të vazhdueshme karshi shqiptarëve në Luginë.



përfshirë edhe Kuvendin, me dokumentin konsultativ", ka thënë Bajrami.

Ajo ka thënë se Qeveria e Kosovës ua ka kthyer shpinën qytetarëve. "Qeveria e 51-përqindëshit ju ka braktisur. Ajo ka vendosur me 90 milionë euro t'ua paguajë rrymën bizneseve. Cilat biznese? A janë ato top 50 bizneset që i pati publikuar Hekuran Murati? A mund sot ministri të dalë ta publikojë listën e top 50 bizneseve që përfitojnë nga subvencionimi 90 milionësh?", ka thënë Bajrami. Deputetja e Lidhjes Demokratike të Kosovës, Hykmete Bajrami, ka fajësuar qeverinë për rritjen e çmimit të energjisë elektrike.

Kurse kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë që qeveria Kurti është një mashtrim. "Qeveria Kurti është mashtrim. Nuk pres nga ju, deputetë të Vetëvendosjes, ta pranoni këtë. Po ja, po jua jap

argumente pse është mashtrim. Në vazhdimësi dëgjojmë Kurtin duke u thënë përkrahësve të vet se po i shpërthejnë minat e kurdisura nga qeveritë e kaluara. Ky është arsyetimi që ua jep atyre afër vetes. Është sikur një komandant t'i thotë ushtrisë po e mbysim veten në mina që na kanë lënë para nesh", ka thënë Haradinaj.

Ai i ka bërë thirrje qeverisë Kurti që ta shfuqizojë vendimin e ZRRE-së për tarifa të reja të energjisë elektrike. "Ekzistojnë praktika kur vendimet e institucioneve, qofshin edhe të bordeve si ZRRE apo edhe të vet qeverisë, shfuqizohen. Qeveria duhet ta shfuqizojë vendimin e ZRRE-së së paku deri në një kohë të pacaktuar. Jemi duke hyrë në pranverë, ka ndodhur subvencionimi, do të ulet konsumi, në vjeshtë apo dimër mund të diskutojmë sërish në Kuvend si të veprojmë", ka thënë Haradinaj.

Kusari-Lila: Ky debat është ftuar që të sulmohet qeveria

Shefja e grupit parlamentar e Lëvizjes Vetëvendosje, Mimoza Kusari-Lila, ka mohuar pretendimet e opozitës. Ajo ka thënë se kjo seancë ishte ftuar 50 minuta para se të fillonte një seancë e cila ishte e caktuar një ditë më parë. "Ne jemi me qytetarët dhe natyrisht debatojmë për secilin qytetar. Nëse mund të thoni se keni bërë një zbrëthim të asaj çfarë ka bërë ZRRE-ja atëherë mund t'ju them se ne nuk e kemi bërë, sepse ende nuk e kanë publikuar vendimin. Nuk ka vend në rajon që nuk ka çmim të energjisë të rritur. Masat që janë ndërmarrë në rajon dallojnë. Në Kosovë është propozuar një variant që ndihmon 70 për qind të amvisërisë gjatë dimrit dhe 90

për qind gjatë verës", ka thënë ajo.

Kusari-Lila ka thënë se parulla politike se Vetëvendosja ka ardhur në pushtet për t'i hequr figurat e UÇK-së është e pavërtetë. Ajo ka thënë se duhet të qartësohet se kush nga ata tash është milioner. "Në vitin 2017 u hoqën tarifat, prej atëherë 41 për qind është rritur konsumi. Është bërë shumë e lirë të konsumohet energjia edhe për ngrohje. Ka pasur mundësi të tjera dhe ato janë hequr. Masat e eficiencës janë zgjidhje tjetër. Kosova është e pasur me rezervat e thëngjillit. Çka ndryshoi këto dy vjet?", ka thënë ai.

Derisa për situatën në veri me energji elektrike, ujë të pijshëm dhe tatim në pronë, ajo ka thënë se asnjë nga qeveritë deri tash nuk ka ndërmarrë asnjë veprim. Sipas Kusarit-Lila, asnjë komunitet nuk duhet të privilegohet.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) të martën ka aprovuar tarifat e energjisë elektrike për vitin 2022. Sipas vendimit, bllok tarifa do të zbatohet për konsumatorët që harxhojnë mbi 800 kWh. Tarifat për konsumatorët familjarë, për nivelin e konsumit deri në 800 kWh në muaj, do të mbesin të njëjta, ndërsa diferenca e konsumit mbi 800 kWh për muaj do të faturonhet me tarifën e ulët (gjatë natës) prej 5.9 dhe tarifën e lartë (gjatë ditës) prej 12.52 centë.

Për ta lehtësuar barrën e qytetarëve nga rritja e çmimit të rrymës, Qeveria e Kosovës ka ndarë një shumë prej 90 milionë eurosh në formë subvencionimi për ta. Subvencionet e qeverisë do të shfrytëzohen për një periudhë njëvjeçare. Tarifat e reja kanë hyrë në fuqi të mërkurën dhe do të aplikohen deri më 31 mars 2023.

Vihet në funksion aparati i mamografisë në QKMF-në e Rahovecit

RAHOVEC, 9 SHKURT (ER) - Komuna e Rahovecit dhe Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare "Fahredin Hoti" në Rahovec kanë vënë në funksion aparatit e mamografisë i cili shërben për ta identifikuar dhe diagnostifikuar me kohë

kancerin e gjirit. Saranda Sallteku, drejtoreshë e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Drejtuesje Sociale, është shprehur se aparati i mamografit vlerësohet të jetë një prej asetëve më me rëndësi për mjekësinë primare, sidomos në aspektin

shëndetësor, për parandalimin me kohë të sëmundjes së kancerit të gjirit. "Komuna e Rahovecit me një investim si ky, ka investuar direkt në shëndetin e grave-nënave si shtyllë kryesore e familjes dhe mirëqenies së saj. Të gjitha gratë

që duan dhe u rekomandohet nga mjeku përkatës mamografia, lutën të bëjnë paraprakisht terminët në QKMF 'Fahredin Hoti'. Së bashku për shëndetin e mirë të gruas", ka thënë drejtoresha Sallteku.



Filloi hartimi i rregullores në Malishevë për taksa, ngarkesa dhe gjoba për vitin 2022

MALISHEVË, 9 SHKURT (ER) - Bazuar në obligimet ligjore, Drejtoria për Buxhet dhe Financa në komunën e Malishevës ka filluar procedurat për hartimin e Rregullores për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoba komunale për vitin 2022, rregullore e cila duhet të hartohet çdo vit. Në kuadër të zhvillimit të këtyre procedurave, të mërkurën është mbajtur një takim, i drejtuar nga nënkryetari i komunës së Malishevës, Vesel Krasniqi, me të gjitha drejtoritë dhe sektorët përgjegjës, për hartimin e kësaj rregullore që, sipas nënkryetarit Krasniqi, "është një prej dokumenteve kryesore që

përcakton politikat zhvillimore në komunën e Malishevës". Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Blerim Thaçi, e ka paraqitur rregulloren e cila duhet të hartohet duke u bazuar në ligjet në fuqi, përderisa e ka vlerësuar si një prej "dokumenteve më të rëndësishme komunale, prandaj është e domosdoshme që sektorët t'i paraqesin propozimet e tyre për hartimin e rregullores". Drejtoritë dhe sektorët e caktuar në komunën e Malishevës i kanë dhënë propozimet e tyre të cilat do të futen në këtë rregullore para se të kalojë për shqyrtim në kuvendin e komunës.



Kryetari i Gjilanit nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me universitetin e UBT-së



GJILAN, 9 SHKURT (ER) - Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, ka nënshkruar të mërkurën marrëveshje të rëndësishme bashkëpunimi me rektorin e Universitetit për Biznes dhe

Teknologji (UBT), prof. dr. Edmond Hajrizi, përmes së cilës do të përfitojnë dy institucionet. "Prita në takim pune rektorin e Kolegjit UBT, Universiteti për Biznes dhe Teknologji, prof. dr. Edmond Hajrizi.

Nënshkruam memorandum bashkëpunimi me qëllim të lidhjes së bashkëpunimit, nga i cili mund të përfitojmë të dyja institucionet. Diskutuam rreth krijimit të platformave të ndryshme digjitale,

kryesisht në kuadër të bibliotekës dhe shkollave të Gjilanit. Përmes lansimit të këtyre platformave synojmë lehtësimin e shërbimeve shkollore dhe qasje mobile të sigurta pa pengesa me pajisje të ndryshme.

U dakorduar se përmes bashkimit të kapaciteteve tona, në të ardhmen të implementojmë këto projekte profesionale për një Gjilan inovativ", ka thënë kryetari i Gjilanit, Alban Hyseni.

Në 2021-n në spitalin e Vushtrrisë janë kryer mbi 1 000 ndërhyrje kirurgjike



VUSHTRRI, 9 SHKURT (ER) - Vitin e kaluar, gjatë periudhës janar-dhjetor, në sallat e operacionit të Spitalit të Përgjithshëm të Vushtrrisë janë kryer 1 093 ndërhyrje kirurgjike me laparoskop. Mjekët kirurgë, bashkë me anesteziologë dhe pjesën tjetër të ekipit operator, për 12 muaj suksesshëm kanë

operuar me metodën klasike (kirurgji e hapur) edhe 590 pacientë. Këto të dhëna dalin nga raporti vjetor i punës, në të cilin është regjistruar në detaje edhe ofrimi i shërbimeve mjekësore në Repartin e Gjinekologjisë, ku janë kryer 296 lindje - 106 me operacion, gjersa janë lindur 297 fëmijë.

Në Spitalin e Përgjithshëm të Vushtrrisë në vitin 2021, po ashtu, janë bërë 46 634 vizita ambulantore, 23 516 vizita diagnostike dhe 58 613 analiza laboratorike për 7 mijë e 757 pacientë. Sa iu përket shërbimeve radiologjike, janë kryer 62 CT, 2 839 ultrazë, 8 294 radiografi dhe 233 mamografi.

Tërheqje e imponuar për restaurimin e një shtëpie



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Xhafer Deva është një figurë kontroverze rreth të cilit thyhen shumë shpata dhe mendime; nacionalistët dhe patriotët shqiptarë e ngrenë në pedestalin e një figure të pakontestueshme patriotike që tërë jetën ia kushtoi luftës për çlirim dhe bashkim kombëtar, ndërsa komunistët jugosllavë dhe shërbëtorët e tyre e konsiderojnë si një kolaboracionist, në shërbim të nazizmit dhe fashizmit përgjegjës për krime ndaj serbëve, hebrejve dhe komunistëve shqiptarë. Xhafer Deva kishte lindur në Mitrovicë dhe ishte intelektual i shkolluar që shërbeu si ministër për Punë të Brendshme në qeverinë shqiptare me kryeministër, Rexhep Mitrovica. Ishte koha kur shqiptarët e okupuar nga zgjedha sllave frymonin më lirshëm dhe kur arsimiti në gjuhën shqipe shënoi përparim të madh. Nacionalistët dhe patriotët shqiptarë e çmonin rolin e Xhafer Devës, kurse komunistët serbë dhe zorra e trashë e tyre në trajtën e komunistëve shqiptarë e konsideronin tradhtarë sepse këta nuk

angazhoheshin për fe dhe atdhe, por u shërbenin qençe serbëve. Xhafer Deva kishte një shtëpi në Mitrovicë, thuaja buzë shkatërrimit dhe kur, më në fund u mor një vendim për restaurim si vlerë e trashëgimisë kulturore, Serbia reagoi e para, pastaj ambasadori gjerman në Kosovë dhe disa figura aspak të shquara për kontribut për çlirim dhe liri të Kosovës, përkundrazi i tërë trugu i tyre gjenealogjik kishte qenë në shërbim të Jugosllavisë dhe Serbisë, ndërsa këta bëjnë shtatë palë qejfe në Kosovën e lirë dhe të pavarur në sajë të kontributit që ua bënë serbëve paraardhësit e tyre biologjikë dhe politikë. Pastaj, si kujdestare e përhershme apo ndrikulla e liberalizimit të dështuar të vizave për Kosovën reagoi Violina e çakorduar Von Kramon sikur edhe mbështetësit financiarë të këtij restaurimi, BE dhe UNDP. Ministria e Kulturës u tremb më shumë se që duhej dhe ky restaurim u ndalë, më shumë për t'i bërë qejfin Serbisë se për shkak të kaluarës së Xhafer Devës. Realisht, gjithkund në botë janë restauruar dhe mirëmbajtur të gjitha objektet që ndërlidhen me nazizmin, Hitlerin, Musolinin, Sasakavën, Vishin, Pinoçetin, Frankon dhe të tjerët, jo për t'i afirmuar politikën e tyre për ta ruajtur kujtesën historike. Pse shtëpia e Xhafer Devës duhet të paraqesë përjashtim kur personaliteti i tij konsiderohet si vlerë e përrjetshme politike dhe kombëtare tek ata shqiptarë që nuk e kanë përkrahur asnjëherë

komunizmin. I mjerë dhe i pashpresë është ai popull që, nën presion të antivlerave kombëtare dhe për shkak të oportunitetit politik, heq dorë nga vlerat e mirëfillta kombëtare. Një intelektual me proveniencë jugosllave thotë se

Xhafer Deva paska vlarë 40 veta në Tiranë, shqiptarë dhe të huaj, por nuk e përmend faktin se komunistët serbë, jugosllavë dhe shqiptarë vetëm në Drenicë dhe në Mal të Zi kanë vlarë mbi 20 000 shqiptarë që nuk u pajtuan me mbetjen në

Jugosllavi. Nga viti 1945 e deri në vitin 1999 po këta komunistë bënë krime të papara ndaj patriotëve shqiptarë për të cilën e kishin përkrahjen mbetjet sllave dhe serbe që flasin shqip. E pabesueshme! Apo prishmërisht e besueshme.



Çeku thotë se presin ta vazhdojnë projektin për restaurimin e shtëpisë së Xhafer Devës

PRISHTINË, 9 SHKURT - Kosova pret që projekti për restaurimin e shtëpisë së Xhafer Devës në Mitrovicë të Jugut të vazhdojë ka thënë të mërkurën ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku. Ai ka theksuar se njoftimi i 8 shkurtit nga Zyra e Bashkimit Evropian dhe Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) për pezullimin e projektit nuk nënkupton që programi është anuluar plotësisht. "Ne i kuptojmë shqetësimet e partnerëve tanë ndërkombëtarë. Unë jam në komunikim të përditshëm me të gjithë, edhe me ambasadorin e respektuar të Gjermanisë në Kosovë. Të gjithëve u kemi dhënë sqarime shtesë, shteruese për qëllimet tona, për projektin tonë dhe jemi të gatshëm t'u ofrojmë çfarëdo që kanë nevojë, të gjitha sqarimet, t'i shterim të gjitha diskutimet

për të ecur përpara me këtë projekt. Ne mendojmë që punën e nisur bashkë me partnerët tanë ndërkombëtarë duhet ta vazhdojmë tutje dhe nga këtu i ftoj të gjithë për reflektim dhe për racionalitet", ka deklaruar Çeku. Ai ka shtuar se debatet e fundit lidhur me rolin e Xhafer Devës në periudhën e Holokaustit nuk e kanë burimin në Kosovë. "Debatet e ditëve të fundit e ka origjinën në Serbi dhe kjo është shumë e qartë. Paradoksalisht, një shtet që mohimin e gjenocidit dhe rehabilitimin e kriminelëve e ka politikë shtetërore, tenton ta fabrikojë një narracion, duke e portretizuar Kosovën si mohuese të Holokaustit ose duke e paraqitur projektin e restaurimit të këtij monumenti si përpjekje për rishkrim të historisë. Faktet historike janë kokëforta dhe qartësisht nuk



janë në anën e Serbisë", ka thënë Çeku. Pezullimi i restaurimit të shtëpisë së Xhafer Devës erdhi pas debatit të ngritur ditët e fundit. Ambasadori i Gjermanisë në Prishtinë, Jorn Rohde, e ka cilësuar Xhafer Devën

"bashkëpunëtor i ngushtë i nazistëve". Ministri Çeku ka thënë se projekti ka për qëllim restaurimin e monumentit dhe jo që të "rehabilitohet historia e Xhafer Devës", duke shtuar se Kosova është e gatshme të përballet me të kaluarën.

Xhafer Deva ka qenë politikan shqiptar në periudhën e Luftës së Dytë Botërore, 1939-1945. Më 1944 Deva u emërua ministër i Punëve të Brendshme në Qeverinë e Shqipërisë, e cila u formua me mbështetje të Gjermanisë naziste. Më 1 shkurt, BE-ja, UNDP-ja dhe Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit kishin njoftuar për projektin e restaurimit të shtëpisë së Xhafer Devës. Shtëpia e Xhafer Devës thuhet se është ndërtuar në vitin 1930 nga arkitektë dhe punëtorë austriakë. Sipas MKRS-së, objekti ka stil modern perëndimor-evropian dhe është i pari i këtij lloji në Mitrovicë. Karakterizohet me dekorime të shumta që, sipas MKRS-së, janë tipike për stilin e tij. Shtëpia është në listën e përkohshme të monumenteve të mbrojtura të trashëgimisë kulturore në Kosovë.

Amerika është më e fortë nga sa duket



Nga Walter Russell MEAD
"The Wall Street Journal"

Vëmendja e botës mund të jetë e përqendruar me të drejtë tek sfida e Rusisë ndaj Ukrainës. Por administrata e presidentit amerikan Joe Biden, përballet me një problem shumë më të madh: një sfidë në rritje nga Kina, Rusia dhe oportunistët si Irani dhe Koreja e Veriut ndaj rendit global që trashëgoi SHBA, nga një Perandori Britanike e lëkundur në vitet 1940. Ndërsa Vladimir Putin e ka forcuar ndikimin e tij në Bjellorusi, dhe e ka përshkallëzuar "luftën e nervave" ndaj Ukrainës, Kina sinjalizoi mbështetjen e saj për politikën e Rusisë në Ukrainë. Po ashtu ajo dërgoi një numër rekord avionësh luftarakë në zonën e mbrojtjes së Tajvanit, kreu stërvitje të përbashkëta detare me Rusinë pranë Japonisë, dhe e shtoi praninë e saj detare midis Japonisë dhe Tajvanit.

Ndërsa ambasadori i Kinës në Shtetet e Bashkuara, paralajmëroi për një rrezik në rritje të shpërthimit të luftës mbi ishull, Jin Canrong, një nga analistët më të njohur kinezë, që ka shumë kontakte në radhët e drejtuesve të lartë të Partisë Komuniste Kineze, parashikoi se Kina do të kryente një "bashkim me dhunë" me Tajvanin brenda vitit 2027.

Për disa ekspertë, ky

përshkallëzim i krizave globale, ilustroi më së miri limitet e fuqisë amerikane. Ata pyesin: Pse për çdo problem në botë, kërkohet ndërhyrja e Amerikës? Pse të mos bëjmë një shkoputje nga hallet e planetit, duke e kthyer vëmendjen ndaj problemeve më emergjente brenda SHBA-së?

Kjo është padyshim një ide joshëse. Por herën e fundit që e provuam, gjërat nuk shkuan dhe aq mirë. Në vitet, 1920 amerikanët shpresonin se mbrojtja e parimeve demokratike, ligjitndërkombëtar dhe bashkëpunimin ekonomik me vendet e tjera, mund të parandalonte një luftë tjetër botërore.

Por kjo nuk ndodhi, dhe pas tronditjes që shkaktoi Lufta e Dytë Botërore dhe armiqësisë së pasluftës nga ana e Josif Stalinit, politikë-bërësit amerikanë vendosën se ndërtimi i një versioni të amerikanizuar të sistemit të vjetër botëror britanik, pra një rend ekonomik global i mbështetur nga fuqia ushtarake amerikane, ishte mënyra më e sigurt dhe më e lirë nga pikëpamja ekonomike për të mbrojtur interesat thelbësore të SHBA-së.

Sistemi i pasvitit 1945 tregoi se ishte i qëndrueshëm dhe efektiv, duke e zbutur ndjeshëm sfidën e sovjetikëve, siguruar integritimin e vendeve post-koloniale në një ekonomi botërore në zgjerim, duke parandaluar luftërat midis fuqive të mëdha përgjatë 7

dekadave, dhe përfshirë në sistem Gjermaninë dhe Japoninë si "aktore të përgjegjshme" në një rend botëror që dikur ishin përpjekur ta shkatërronin.

Pas shembjes së Bashkimit Sovjetik, politikë-bërësit amerikanë shpresonin që ta zgjeronin më tej atë sistem, me Rusinë dhe Kinën që do t'i bashkoheshin Gjermanisë dhe Japonisë si shtylla kryesore të një rendi botëror të udhëhequr nga amerikanët, por ndërkombëtarisht të përgjegjshëm.

Njëkohësisht, amerikanët u përpoqën që të pastronin dhe të ngrinin një rend botëror që nuk përballej më me rivalët armiqësorë komunistë, duke e vënë më shumë theksin tek të drejtat e njeriut, barazia e grave, promovimi i demokracisë, dhe çështje të tjera transnacionale si ndryshimi i klimës dhe emigracioni.

Por versioni i pasvitit 1990 i projektit të vitit të largët 1945 ka hasur shumë rezistencë, sepse Rusia dhe Kina refuzojnë kategorikisht të pranojnë vizionin amerikan të një bote të pas Luftës së Ftohtë.

Në kushtet kur opinioni amerikan është gjithnjë e më i ndarë mbi elementët bazë të strategjisë sonë të ndërtimit të rendit botëror, që variojnë nga tregtia e lirë deri tek garancitë e sigurisë globale, apo edhe rolin që duhet të kenë çështjeve të tilla si ndryshimi i klimës dhe të

drejtat LGBTQ në politikën e jashtme amerikane, po bëhet gjithnjë e më e vështirë që presidentët të gjejnë mbështetje të brendshme sa i përket politikës së jashtme, ndonëse situata globale pobëhet gjithnjë e më e zyrtë.

Por me pesimizmin teprohet lehtësisht. Historia nuk nisi në vitin 1945, dhe ka arsye të rëndësishme strukturore se përse Britania dhe SHBA-ja qenë në gjendje të ndërtonin dhe mbronin një sistem botëror kapitalist liberal, i cili në disa aspekte daton që nga luftërat e shekullit XVII-të midis Britanisë dhe Francës.

Modeli britanik i një shoqërie liberale dhe pro-biznesit në vend, i fokusuar tek tregtia globale dhe fuqia detare, u tregua i fortë dhe i qëndrueshëm. Louis XIV, Napoleoni, Kajzeri Wilhelm II, Adolf Hitleri, Japonia Perandorake dhe Bashkimi Sovjetik, u përpoqën që të shkatërronin sistemin botëror anglo-amerikan, që ishte në zhvillim e sipër.

Të gjithë ata bënë histori, dhe e tronditën deri në themel këtë rend. Por gjithsesi në fund të gjithë ata dështuan. Faktorët që kontribuojnë në suksesin afatgjatë të rendit anglo-amerikan, janë të pranishëm ende sot.


Një shoqëri e hapur dhe një klimë konkurruese në biznes, promovojnë përparimin teknologjik dhe rritjen

ekonomike, të cilat garantojnë politikën tonë të jashtme. Si një fuqi globale detare, e interesuar në parandalimin e fuqive të mëdha tokësore nga dominimi i Evropës ose Azisë, amerikanët janë aleatët natyrorë të shteteve më të vogla që kërkojnë të mbrohen kundër ambicieve të hegjemonëve aspirantë si Kina dhe Rusia.

Politikat dominuese kineze në rajonin e Indo-Paqësorit, i kanë forcuar aleancat e SHBA-së atje, ndërkohë që kërcënimet e Rusisë ndaj Ukrainës po e ripërtërijnë NATO-n, dhe po u kujtojnë evropianëve se pavarësisht të gjithave, Uashingtoni mbetet një aleat i mirë.

Winston Churchill e përgatiti veten për luftën kundër Hitlerit, duke studiuar metodën ushtarake dhe diplomatike të paraardhësit të tij John Churchill që solli fitoren ndaj mbretit të Francës Louis XIV. Theodore Roosevelt ishte një nxënës serioz i historisë britanike dhe amerikane, ashtu si edhe kushëri i tij Franklin.

Mjerisht, në dekadat e fundit sistemi arsimor amerikan, e ka trajtuar me dyshim dhe përbuzje studimin e themeleve të suksesit amerikan. Amerikanët që synojnë të përgatiten për betejat e epokës sonë, do të bënin mirë të rifreskonin dijet e tyre mbi historinë e sistemit botëror, që na kërkohet sërish qëta mbrojmë.



EURO GLASS
SAINT-DONAIN SEKURIT ENVERI
PILKINGTON
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Ademi takohet me drejtuesit e lartë të FIFA-s

Kryetari i FFK-së, Agim Ademi, është takuar me zëvendëssekretarin e përgjithshëm të FIFA-s, Alasdair Bell, dhe presidentin Gianni Infantino. Ademi falënderoi drejtuesit e FIFA-s për përkrahjen e vazhdueshme që i kanë dhënë futbollit të Kosovës



"Epoka e re"

PRISHTINË, 9 SHKURT - Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, është takuar me zëvendëssekretarin e përgjithshëm të FIFA-s, Alasdair Bell, i cili është edhe shef për çështje ligjore në FIFA. Siç dihet, Bell në kohën e pranimin të Kosovës ishte zyrtar ligjor në Konfederatën Evropiane të Futbollit, UEFA dhe e kishte mbrojtur fuqishëm çështjen e pranimin të FFK-së në UEFA më 3 maj në Kongresin e Budapestit, kur FFK-ja ishte pranuar në UEFA. "Presidenti Ademi e falënderoi edhe një herë Bellin për avokimin e tij për

pranimin e FFK-së në UEFA si dhe për gjithë bashkëpunimin në vitet e mëtuajtshme. Në anën tjetër, Belli e uroi presidentin Ademi për punën në krye të FFK-së dhe tha se progresi që ka bërë Federata e Futbollit të Kosovës në vitet pas pranimin ka dëshmuar që kauza të cilën ai e ka mbrojtur në Budapest ka qenë e drejtë", thuhet në njoftimin e FFK-së. Shtëpia e futbollit të Kosovës ka njoftuar, po ashtu, se kryetari Ademi gjatë qëndrimit në Emiratet e Bashkuara Arabe ka bashkëbiseduar edhe me presidentin e FIFA-s, Gianni Infantino. Në këtë takim u diskutua për zhvillimet e futbollit të Kosovës dhe projektet e

realizuara nga FFK-ja. Presidenti Ademi e falënderoi kreun e FIFA-s për mbështetjen e vazhdueshme dhe simpatinë që ka treguar ndaj futbollit të Kosovës. Ata së bashku ndoqën ndeshjen gjysmëfinale të Kupës së Botës për klube ndërmjet Palmeirasit dhe Al Ahly. Në fakt, Infantino që nga koha kur Kosova u pranua në FIFA ka pasur një relacion shumë të mirë dhe të afërt me FFK-në dhe me presidentin Ademi, gjë të cilën e dëshmon edhe përkrahja e tij e vazhdueshme dhe respekti ndaj tij, pasi nuk ka asnjë ngjarje të cilin e organizon FIFA, në të cilin nuk ftohet kreu i FFK-së nga presidenti Infantino.

SHKURT

Ekipi olimpiq i Kosovës viziton skitarin shqiptar Dardan Dehari

Ekipi olimpiq i Kosovës e ka vizituar të mërkurën skitarin shqiptar të Maqedonisë së Veriut, Dardan Dehari, i cili të martën lëndoi gjurin gjatë përgatitjeve për të realizuar ëndrrën për garim në Lojërat Olimpikë Dimërore "Pekini 2022". Dehari, që kishte bartur flamurin në ceremoninë hapëse, pritet të kthehet në vendlindje për t'iu nënshtruar operimit. Ekipi olimpiq i Kosovës i dëshiroi shërim të shpejtë, me shpresën se do ta kalojë sa më parë këtë sfidë. Ai është dashur të garojë në disiplinat e sllallomit dhe sllallomit të madh.

Vazhdon interesimi i Mourinhos për Xhakën

Trajneri i Romës, Jose Mourinho, dështoi ta transferojë Granit Xhakën në verën e kaluar, por ai ende nuk ka hequr dorë nga transferimi i futbollistit shqiptar, raporton "Epoka e re". "The Sun" raporton se Xhaka kishte arritur marrëveshje me klubin italian, por ishte Arsenali që nuk lejoi realizimin e këtij transferimi. Vlera e Xhakës është mbi 20 milionë euro, derisa portugezi Mourinho do ta tentojë transferimin në afatin kalimtar të verës.

Kaçë transferohet në kategorinë e dytë të Greqisë

Ergys Kaçë u largua nga Partizani pas vetëm gjashtë muajsh, pa lënë gjurmë, dhe tani do të aktivizohet sërish në Greqi. Mesfushori që ka qenë me Shqipërinë në "Euro 2016" do të jetë pjesë e skuadrës së Veria NFC në ligën e dytë greke. Ai ka firmosur për gjashtë muaj me ekipin e vendit të parë, që synon me çdo kusht të ngjitet në elitë. PAOK, Anagennisi Epanomi, Viktoria Plzen, AEL, Aris dhe Partizani Tirana janë skuadrat në të cilat janë aktivizuar në karrierë Kaçë. Kaçë është 28-vjeçar teksa me Kombëtaren e Shqipërisë i ka regjistruar 28 paraqitje dhe ka realizuar dy gola.

Tahiri garon sot, synon top 15-shën

PRISHTINË, 9 SHKURT - Skitari i Kosovës, Albin Tahiri, do të garojë sot (e enjte) në kombinim alpin, disiplinë kjo që përbëhet nga lëshimi

dhe sllallomi. Komiteti Olimpik i Kosovës ka bërë më dije se Tahiri synon që të renditet në top 15-she. "Meqenëse numri i garuesve

është vetëm 27 sosh, shkak i mungesës së normave olimpikë të skitarëve në të dyja disiplinat, skitarit tonë i janë shtuar ambiciet për të

përfunduar në mesin e 15 më të mirëve në Lojërat Olimpikë Dimërore "Pekini 2022", thuhet në njoftimin e KOK-ut.



Në Zvicër e kritikojnë Shaqirin për transferimin në Amerikë

CYRIH, 9 SHKURT - Një lajm merkatoje qarkullon kohët e fundit se Xherdan Shaqiri do të largohet nga Lyoni me dëshirën e tij për t'u transferuar në MLS. Intervistë e ashpër në gazetën "Ticino", ku flitet për vazhdimin e karrierës së Xherdan Shaqirit në

moshën 30-vjeçare në MLS, te Chicago Fire. Arno Rossini, një trajner me përvojë të madhe, ka folur për këtë çështje shumë i irrituar. "Në moshën 30-vjeçare Shaqiri ende mund të luante për një kohë të gjatë duke veshur fanellën e Zvicrës, por me

transferimin e tij në Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të kalonte në plan të dytë për një vend titullari në kombëtare. Ai do të vinte gjithmonë me vonësë nga Amerika për t'u grumbulluar me kombëtaren e tij. Shaqiri gjithmonë ka qenë lojtari më i

rëndësishëm i Zvicrës, por tani ai po e braktis për disa para më shumë në fund të sezonit. Ai ka luajtur në klube të mëdha si Inter, Bayern Munchen dhe Liverpool, por kurrë nuk ka pasur merita kur klubet fitonin trofe", është shprehur i irrituar Rossini.



Mourinho, pas eliminimit të Romës: Interi do të jetë gjithmonë familja ime

ROMË, 9 SHKURT - Me të hyrë në stadium, banderolat për nder të tij ishin në çdo cep të "San Siro"-s, ndërsa Jose Mourinho shpërndau puthje kudo, derisa erdhi edhe vërshëllima për fillimin e ndeshjes. Gjithsesi, edhe gjatë saj koret për nder të "Special One" nuk munguan, duke bërë që për disa momente të harrohej se portugezi kishte ardhur si kundërshtar dhe për t'i eliminuar zikaltrit, ata me të cilët fitoi "tripletën", siç e pranoi vetë ai. "Interi dhe interistët do të jenë gjithmonë familja ime. Do të jem i lidhur përjetë me këtë klub, edhe pse e vërteta është se erdha këtu për t'i mundur dhe për të vazhduar më përpara në Kupën e Italisë. Në fund nuk ia dolëm, pasi e hodhëm ndeshjen tonë në erë me 5 minuta të para skandaloze ku ishim, thjesht, të papërqendruar, ndërsa më pas bëmë një paraqitje mjaft të mirë. Madje në pjesën e parë, me Zanilon dhe Abrahamin, ju betohem se e pashë topin në



rretë, duke parë edhe rastet e pastra që krijuam, por në fund ishte thjesht një iluzion", ka thënë Mourinho. "Më vjen keq, por nga ana tjetër jam i bindur kur them se përballë kishim një Inter, i cili është ekipi më i fortë në Itali për momentin dhe jam i lumtur për ta. Drithërima për rikthimin? Më kishte munguar 'San Siro', sepse ky stadium më kujton vetëm ngjyrat e argjendta dhe të kristalta, si ato copat e

letrave të festimeve pas çdo trofeu të fituar që bien nga qiell. Por, në të njëjtën kohë, të mos harrojmë se, përveç Interit, unë tashmë dashuroj edhe Romën, me të cilën dua të vazhdoj të punoj fort, pasi besoj te ky projekt dhe të fitojmë gjëra të rëndësishme së bashku në vazhdim. Kupa e Italisë ishte një objektivi yni, por na mundi skuadra më e fortë në Itali", ka shtuar Mourinho.

Giannisi fiton duelin me LeBron, triumfojnë Phoenixi dhe Memphis

LOS ANXHELOS, 9 SHKURT - Kampionët e Milwaukee Bucksit fituan me rezultat 131-116 në fushën e lakersave, një ndeshje e dominuar nga miqtë, që ngjiten në vendin e dytë në Konferencën e Lindjes. Antetokounmpo ishte magjik në parket, autor i 44 pikëve e 14 reboundeve, duke i bërë të



pavlefshme 27 pikët e LeBron Jamesit. Humbet edhe ekipi tjetër i Los Anxhelosit, ai i Clippersit, që u mund 135-109 nga Memphis, që ngjitet i treti në Perëndim. Ja Morant me 30 pikë e Jacksoni me 26 pikë ishin më të mirët për Memphisin. Vijnë kriza e Brooklynit, që pësoi humbjen e nëntë radhazi në kampionat. Netsi

u mund në fushën e vet 126-91 nga Boston (Brown e Smart 22 pikë secili). Në krye të renditjes në Perëndim qëndron Phoenixi, që sot fitoi 114-109 ndaj Philadelphia (Booker 35 pikë), ndërsa Dallasi fitoi me rezultat 116-86 ndaj Detroitit falë 33 pikëve e 11 asistimeve të Luka Donçiqit, më i miri në fushë.

REZULTATET

Philadelphia - Phoenix	109-114
Atlanta - Indiana	133-112
Brooklyn - Boston	91-126
Memphis - Clippers	135-109
New Orleans - Houston	110-97
Dallas - Detroit	116-86
Denver - New York	132-115
Lakers - Milwaukee	116-131
Portland - Orlando	95-113
Sacramento - Minnesota	114-131

Inzaghi: Fitore e rëndësishme ndaj Romës, tani presim Napolin dhe Liverpoolin

Interi mposhti Romën (2-0) në çerekfinale të Kupës së Italisë dhe ka siguruar kalimin në gjysmëfinale. Trajneri Simone Inzaghi ka thënë se fitorja ishte e rëndësishme për skuadrën ndaj një kundërshtari të fortë, derisa tash fokusi duhet të jetë

në ndeshjen ndaj Napolit dhe Liverpoolit. "Djemtë ishin shumë mirë. Nuk ishte një ndeshje e lehtë. Roma ka një ekip cilësor me një skuadër të shkëlqyer. Ne e mbajtëm mirë fushën dhe e merituam gjysmëfinalen. E përgëzoja

ekipin. Ata ishin të mirë në organizimin e një ndeshjeje personaliteti në vetëm dy ditë e gjysmë pas derbit. U mërzitëm për dëmtimin e Bastonit. Shpresojmë mos të mungojë për një kohë të gjatë pasi për ne ai është një shtyllë

e mbrojtjes. Perisqi bëri një lojë fantastike. Ai gjithmonë ka qenë në këtë formë. Është një lojtar shumë i rëndësishëm për ekipin tonë pasi të gjithë e kemi parë se si e menaxhon krahun e tij të majtë", ka thënë Inzaghi. "Duhet ta

menaxhojmë anën tonë psikologjike dhe pak atë fizike. Kemi ndeshje shumë të rëndësishme këtë muaj. Milani dhe Roma luajtën me ne. Tani kemi Napolin dhe Liverpoolin. Kalendar i ngjeshur për ne", ka shtuar Inzaghi.

SHKURT

Watfordi e dëshiron Strakoshën

Portieri shqiptar Thomas Strakosha duket gjithmonë e më larg Lazios, edhe pse në javët e fundi ka rifituar vendin e titulluarit. Portieri kuqez i ka përfunduar në orbitën e skuadrës së Watfordit. Sipas "Sportmediaset", kontaktet kanë nisur dhe po ecin mirë pasi oferta në tavolinë është tërheqëse ekonomikisht. Shumë nga zgjedhja e Strakoshës do të varet nga qëndrimi ose jo i tyre në elitën e futbollit anglez. Nëse Watfordi bie në Championship, Strakosha nuk do ta pranonte ofertën e tyre. "Gardiani" shqiptar pritet që të largohet falas nga Lazio dhe të marrë edhe një rritje në pagë si shpërblim. Gjithsesi në javët e vijim do të kemi dhe një panoramë më të qartë për të ardhmen e tij.

Giovinco nënshkruar për Sampdoria

Ish-ylli i Juventusit, Sebastian Giovinco, i është bashkuar zyrtarisht Sampdorias si transferim i lirë, duke nënshkruar kontratë deri në fund të sezonit. Giovinco kthehet në Serinë A shtatë vjet pas transferimit të tij në Toronto FC nga Juventus. Ai ka shënuar 40 gola në 190 paraqitje në Serinë A ku luajti për Juventusin, Empolin dhe Parmën. "UC Sampdoria njofton se ka fituar përfundimisht të drejtat për regjistrimin e futbollistit Sebastian Giovinco (lindur në Torino më 26 janar 1987). Sulmuesi ka nënshkruar një kontratë ekonomike deri më 30 qershor 2022", thuhet në njoftim e Sampdorias.

Tre yje të PSG-së rrezikojnë të mungojnë ndaj Realit

Që kur Nassser Al Khelaifi zbarkoi te PSG-ja, skuadra parisienne është bërë një nga favoritët çdo sezon për të triumfuar në Ligën e Kampioneve. Gjithsesi kampionët e Ligës 1 jo në pak raste kanë zhgënjyer. Këtë sezon shorti i ka vënë përballë Real Madridit që në fazën e parë me eliminim direkt, por tradita e dëmtimeve vijon t'i shqetësojë. Neymari, Paredesi dhe Ramosi janë në dyshim deri në çastet e fundit për duelin e parë. Gjithçka filloi në sezonin 2012/2013, kur PSG-ja u përballë me Barcelonën në çerekfinale të Ligës së Kampioneve, me Ancelottin në stol. Trajneri italian nuk kishte në dispozicion Thiago Mottën dhe Matuidin, duke ua dhënë mundësinë katalanasve që të kalonin në raundin tjetër. Neymari është dëmtuar shpesh në fazën me eliminim direkt, duke ndikuar jo pak në ecurinë e ekipit të tij.

Haalandi, zëvendësues i Mbappes në PSG

Kýlian Mbappe thuhet të ketë arritur marrëveshje me Real Madridin. Sulmuesit francez në verë i përfundon kontrata me Paris Saint-Germainin, kurse kjo e fundit është duke menduar për zëvendësuesin e Mbappes. Sipas medieve franceze, synimi i drejtuesve të PSG-së është Haalandi i Borussia Dortmundit. Haaland ka mahnitur me formën e tij për klubin e Bundesligës, duke i shënuar 80 gola në 79 ndeshje. Paraqitjet e tij kanë rënë në sytë e klubeve më të mëdha në botë, përfshirë të Parisit, i cili është i përkushtuar ta fitojë garën për norvegjezin e shumëkërkuar. 21-vjeçar i ka edhe dy vjet në marrëveshjen e tanishme me Dortmundin, por ka një klauzolë lirimi në vlerë 70 milionë euro e cila cilësohet si e arritshme për skuadrën e Mauricio Pochettinos.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr. 102/1
 Dt: 09.02.2022

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, Neni 8 i Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Neni 13 dhe 34 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012 (Neni 4), Udhëzimit Administrativ 05/2021, Udhëzimit Administrativ 05/2015, Udhëzimit Administrativ 07/2017 si dhe në bazë të kërkesave të shkollave, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

SHPLLJE E KONKURISIT

Për plotësimin e vendeve të lira në Qendra e Kompetencës “Shtjefen Gjeçovi”, në Prishtinë dhe Qendrën e Kompetencës “11 Marsi”, në Prizren për vitin shkollor 2022/2023

Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita/Vend i lirë	Vendi lirë/ Zëvendësim
SHML	Qendra e Kompetencës “11 Marsi”	Prizren	Një mësimdhënës s/e për lëndën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe me 20 orë mësimore;	Zëvendësim deri në kthimin e mësimdhënësve nga pushimi i lehonisë
SHML	Qendra e Kompetencës “Shtjefen Gjeçovi”, në Prishtinë	Prishtina	Një(1) mësimdhënës/e për lëndë profesionale të makinerisë me 20 orë mësimore; Një(1) mësimdhënës/e për lëndë profesionale të makinerisë me 20 orë mësimore;	Vend i lirë Vend i lirë

Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës të nivelit të IV-të;

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të silllet me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjisllacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrën Kompetencës dhe AAAPARr-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe proceseve mësimore të nxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrën e duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara për mësimdhënës:

- Diploma e përgatitjes profesionale e nivelit të 7 sipas KKK;
- Letërnjoftimi (fotokopje);
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvojës punës në arsim;
- Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet për gatitja adekuate profesionale;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën tryzni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;
- Procedurat e konkurrimit:**
 - Afati i konkurrimit është 15 ditë pas shpalljes. Aplikacionet dhe dokumentet e kërkuara duhet të merren dhe dorëzohen në administratën e institucioneve në të cilat është shpallur konkursi gjegjësisht në Qendrën e Kompetencës “Shtjefen Gjeçovi”, në Prishtinë dhe Qendrën e Kompetencës “11 Marsi”, në Prizren.
 - Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin (për të diplomuarit jashtë vendit dëshmitë e nostrifikimit të diplomës), dëshmia për përvojën e punës, dëshmia që nuk janë nën hetime dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës.
 - Kërkesat e arritura pas mbylljes së konkursit, dhe aplikacionet e pa kompletuara nuk shqyrtohen. Kandidatët të cilët do të ftohen në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale.
 - Në mungesë të kandidatëve me kualifikim adekuat në intervistë thirren edhe kandidatët me kualifikim të përafërt, në të kundërtën intervistohen vetëm kandidatët me kualifikim përkatës.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPLLJE TË VOGLA <<

- Alajdin Tumba shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.
- Ardian Hulaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu " Lidhja e Prizrenit " Prizren.
- Kreshnik Vehapi shpall te pavlefshme diplomën shfmu " Ibrahim Fehmiu " Prizren.
- Abedin A. Begaj shpall te pavlefshme diplomën ShLP Prizren.
- Flamur Gashi Gjakovë, shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Valon Gashi Gjakovë, shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të SH.F.M.U. "Haxhi Hoti" Rogov KK Gjakovë nga kl. I-V dhe VI-IX.
- Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales

